

## POETJA GREKE RITA BUMI PAPA DHE PËRKTHIMI I VEPRËS SË SAJ NË GJUHËN SHQIPE

**Msc. Mirela Koça**

Departamenti i Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek  
Fakulteti i Edukimit dhe i Shkencave Shoqërore  
Universiteti «Eqrem Çabej» Gjirokastrë  
E-mail: mkoca@uogj.edu.al

### PËRMBLEDHJE

Kumtesa është rezultat i punës kërkimore në kuadrin e procesit të përgatitjes së tezës doktoale me temë: “Ndjeshmëria poetike e shkrimtareve femra në Greqi pas viteve 1930” dhe ka si objekt poeten e letërsisë bashkëkohore greke Rita Bumi Papa, përkthimet, si dhe jehonën e veprës së saj në Shqipëri. Është ndër poetet e para të letërsisë bashkëkohore greke të përkthyer në gjuhën shqipe dhe i përket përkthimeve në periudhën e monizmit 1945-1990.

Në këtë punim zbatohen dy metoda bazë: a. metoda kontrastive-krahasuese dhe b. konceptuale, në formën e analizës semantike. Përfshin jo vetëm një analizë tekstuale të përkthimeve, me theks në mënyrën se si jepen referencat kulturore, por edhe një analizë të formës dhe përzgjedhjes së poezive të përkthyer.

Fjalët çelës: Rita Bumi Papa, Letërsia Femërore Bashkëkohore greke, përkthimi, karakteristika

### ABSTRACT

The paper is the result of research work in the framework of the process of preparing the doctoral thesis on the topic: “Poetic sensitivity of female writers in Greece after the 1930s” and has as its object the poet of Modern Greek literature Rita Bumi Papa, the translations, as well as the echo of her work in Albania. In this work, two basic methods are applied: a. contrastive-comparative method and b. conceptual method in the form of semantic analysis. It includes not only a textual analysis of the translations, with an emphasis on how cultural references are made, but also an analysis of the form and selection of the translated poems.

Key words: Modern Greek Women’s Literature, Rita Bumi Papa, translation, Albanian language

Kumtesa është rezultat i punës në kuadër të përgatitjes së tezës së doktoratës me temë: “Ndjeshmëria poetike e shkrimtareve femra në Greqi pas viteve 1930” dhe ka si objekt poeten e letërsisë bashkëkohore greke Rita Bumi Papa, përkthimet, si dhe jehonën e veprës së saj në Shqipëri.

Siç dihet, përkthimi është një nga mjetet më integrale të kryqëzimeve gjuhësore dhe funksionon si një nga mekanizmat kryesorë të shkëmbimit dhe kontaktit kulturor për transmetimin e elementeve historike, politike, kulturore dhe sociale.<sup>1</sup> Është një veprim intelektual kërkues që i referohet si procesit të përkthimit ashtu edhe rezultatit të tij.

Përkthimi funksionon si “*ndërmjetësim ndërgjuhësor*”, duke përcjellë mesazhe nga një gjuhë në tjetrën, duke luajtur në historinë njerëzore një rol kyç.<sup>2</sup> Letërsia e përkthyer “është një pjesë përbërëse e sistemit më të gjerë kulturor ku marrëdhëniet letrare dialektike të formuara përmes përkthimit kontribuojnë në evolucionin kulturor dhe në komunikimin ndërkulturor”<sup>3</sup>.

Në Shqipëri ekziston një traditë e gjatë përkthimesh nga greqishtja e vjetër, fillimet e të cilave mund të gjenden në epokën e Rilindjes Kombëtare. Kjo traditë kontribuoi ndjeshëm në hapjen e rrugës për përkthimet e veprave të letërsisë moderne greke. Vepra e parë e letërsisë bashkëkohore greke në gjuhën shqipe u përkthye në vitin 1911 dhe është romani dramatik me titull “*Gabimi i tmerruar*”, i një autori të panjohur, që u botua në Korçë, me përkthyes Thomas Avramis. Veprat e përkthyer të letërsisë moderne greke në gjuhën shqipe mund të ndajmë në tre periudha:

- a) Periudha e parë nga viti 1912, viti i krijimit të shtetit shqiptar, deri në vitin 1944.
- b) Periudha e dytë nga viti 1945 deri në vitin 1990.
- c) Periudha e tretë nga viti 1991 e në vazhdim.

Poetja Rita Bumi-Papa i përket periudhës së dytë, nga viti 1945 deri në vitin 1990. Me ndryshimin e regjimit shtetëror në Shqipëri pas Luftës së Dytë Botërore, dhe më konkretisht me marrjen e pushtetit nga Partia Komuniste në vitin 1944, ndryshon gjithë situata rreth veprimtarisë së përkthimit. Duket qartë vula e fortë e klimës mbytëse politike nën të cilën jetoi shoqëria shqiptare nga viti 1945 deri në 1990.

1. Κασίνης, Κ.Γ.: Διασταυρώσεις. Μελέτες για τον ΙΘ΄και Κ΄αι., τόμ. Α΄, Β΄ έκδοση, Εκδόσεις Χατζηνικολή, Αθήνα 2003, f. 11

2. Ladmiral, J.R. (2007). Θεωρήματα για τη μετάφραση (μτφ. Κ. Κολλέτ, Μ.Χ. Αναστασιάδη). Αθήνα: Μεταίχμιο., Munday, J. (2004). Μεταφραστικές σπουδές: θεωρίες και εφαρμογές (μτφ. Α. Φιλιππάτος). Αθήνα: Μεταίχμιο.

3. Δημητρούλια, Τ. και Κεντρωτής, Γ. Λογοτεχνική μετάφραση. Θεωρία και πράξη. Αθήνα: Κάλλιπος 2015, f. 157

Regjimi komunist, që u vendos menjëherë pas çlirimit, bazohej në diktaturën e proletariatit dhe në luftën e klasave. Njerëzit jetonin të ndrydhur në një vend ku mungonte liria e fjalës dhe pluralizmi politik. Duke iu nënshtruar censurës së vazhdueshme, shtypi, literatura, letërsia e kohës ishin armë në duart e shtetit. Kjo letërsi njihet me termin *“Letërsi e realizmit socialist”* dhe *“është një letërsi misionare e shkruar në funksion të edukimit komunist të masave, krijimit të njeriut të ri, shpirtërisht të depersonalizuar dhe ideologjikisht të infektuar”*<sup>4</sup>. Sipas Gorkit *“realizmi socialist pranon se jeta është akt dhe krijim, që kërkon të zhvillojë në vazhdimësi aftësitë individuale më të vlefshme të njeriut, për të qenë në gjendje të jetojë i lumtur në tokë...”*<sup>5</sup>.

Çdo vepër letrare, para se të botohej, i nënshtrohej një censure të rreptë. Dhe veprat e përkthyer i kalonin të njëjtës procedurë, veçanërisht librat që vinin nga Letërsia Perëndimore. Veprimtaria e përkthimit, tashmë, është një veprimtari kulturore e organizuar dhe e institucionalizuar që financohet nga shteti. Në shtëpitë botuese, do të përzgjidheshin për përkthim veprat të cilat nuk ishin në kundërshtim me ideologjinë e doktrinës së realizmit socialist.

Edhe pse Greqia dhe Shqipëria pas vitit 1944 kaluan në kampe politike kundërshtare dhe marrëdhëniet mes tyre ishin të kufizuara, disa shkrimtarë grekë u përkthyen në gjuhën shqipe. Natyrisht, e gjetën më lehtë rrugën e njohjes autorët që pikëpamjet dhe në përgjithësi vepra e tyre përputheshin me ideologjinë komuniste të regjimit të asaj kohe. Kështu përkthehen Ricos, Kazantzakis, Varnalis, Ludemis, Livaditis, Malamas etj. Përkthyesit fillimisht ishin poetë të njohur, prozatorë, gazetarë, grekë nga Minoriteti Etnik Grek në Shqipëri dhe shqiptarë që kishin studjuar kryesisht në Greqi, të cilët i njihnin shumë mirë të dyja gjuhët si Aleks Çaçi, Pano Çuka, Ismail Kadare, Dritëro Agolli, etj.

Poetja e parë greke që përkthehet në gjuhën shqipe është Rita Bumi-Papa. Siç thekson Ll. Siliqi *“ajo, fill pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, ka qenë, si të thuash, dallëndyshja e parë e poezisë së re greke në Shqipëri”*<sup>6</sup>. Vepra e saj e gjerë përfshin poezi, tregime të shkurtra, romane, antologji poetike, letërsi udhëtimi dhe përkthime të veprave

4. Lazër Stani Censura dhe shkrimtarët shqiptarë në diktaturë, 12 Mars 2021 <https://www.panalbanian.com/shqiperia/censura-dhe-shkrimtare-shqiptare-ne-diktature/>

5. Γκόρκυ, Μ., Ο σοσιαλιστικός ρεαλισμός, μτφ. Ανδρέας Σαραντόπουλος, Σύγχρονη πεζογραφία, Αθήνα: 1979. f. 64

6. B.P, Rita (1985). *Një mijë vajza të vrara dhe poezi të tjera*, përkth. Aleks Çaçi. Tiranë: Naim Frashëri f. 13

të poetëve dhe prozatorëve jo vetëm nga vendet fqinje të Ballkanit, por pothuajse nga e gjithë Evropa. Sot është e njohur në Greqi kryesisht për përkthimet e saj dhe së bashku me Zoi Kareli, Melisanthi dhe Melpo Aksioti i takon poezisë femërore të Brezit të Viteve 1930.

Lindi në vitin 1906 në Ermupoli të ishullit Siros, një qendër tregtare, detare dhe industriale. Babai i saj, Mastro-Nikolis, një ndërtues varkash me vela, vinte nga Hidra, ndërsa gjyshi i saj Petros Bumis kishte paraardhës një arvanitas të quajtur Aleksandri. Rita flet me krenari për paraardhësit e saj në romanin biografik kushtuar nënës së saj *"Kriso"*, duke theksuar se plakuri Skënderi i kishte dhuruar *"dy skune (një lloj anije) për lirinë e atdheut"* dhe kur Kapodistria, Kryetari i parë Qeveritar i Greqisë, e ftoi në Nafplio më 1828 për ta dekoruar, duke u kthyer në Hidër, e hodhi çmimin në zjarr duke thënë: *"Atdheun nuk e kam dhënë hua për t'u pasuruar"*. Nëna e saj, e lindur dhe e rritur në Patmos, vatër e Ortodoksisë, ishte *"një grua mendimtare, me një psikikë të trashëguar nga një familje që kishte nxjerrë igumenë dhe murgj në ishullin e Apokalipsit"*<sup>7</sup>. Rita jetoi një fëmijëri në varfëri, sepse me shpikjen e avullit si fuqi lëvizëse puna e të atit filloi të binte. Por kjo situatë u përkeqësua edhe më shumë, me vdekjen e parakohshme të nënës së saj, të cilës i kishte një dobësi të veçantë.

Mbaroi gjimnazin dhe më pas vazhdoi Shkollën Franceze të Murgeshave *"Shën Josifi"*. Në vitin 1920 u vendos në Sirakuzë të Sicilisë, ku jetonte vëllai i madh i saj i pasur. Qëndroi deri në vitin 1928. Atje studjoi për pedagogji dhe u specializua në metodën Montessori. Në të njëjtën kohë studjoi letërsinë franceze dhe italiane, veçanërisht poezinë, dhe filloi të përkthente poetë italianë dhe francezë. Në vitin 1924, në moshën 13-vjeçare, botoi vargjet e saj të para në revistën *"Diaplasia"* dhe redaktori i saj, G. Ksenopoulos, e "promovoi" në bashkëpunëtorë të rregullt. Më 1928 kthehet në Greqi dhe punon si gazetare dhe përkthyes në shumë revista dhe gazeta si *"Nea Estia"*, *"Neon Kratos"*, *"Nei Rithmi"*, *"Alagi"*, *"Avgi"*, bëhet kryeredaktore e revistës *"Ionios Anthologjia"* (nga viti 1929) botuese e revistave *"Efimerida ton piiton"* (1956-1958) dhe *"Kiklades"* (1930-1932) dhe drejtoreshë e Fondacionit *Kujdesi për Fëmijët*. (1930-1933). Në vitin 1936 u martua me poetin Nikos Pappas, me të cilin jetoi në Trikala deri në vitin 1940. Më pas u vendosën në Athinë dhe jetuan pjesën tjetër të jetës. Në letërsi u shfaq për herë të parë në vitin 1929 me botimin e poezisë së saj *"Vagabondi im i vogël..."* (*"Μικρέ μου Αλήτη..."*) në *"Nea Estia"*. Ka botuar 17 vëllime poetike, një vëllim me

7. Ρίτα Μπούμη-Παπά, Η Χρυσώ, Αθήνα, Καρανάσης 1984 f. 179

tregime dhe një roman autobiografik. Ka përkthyer shumë poetë të huaj (rusë, francezë etj.), ndërsa poezitë e saj u përkthyen në italisht, anglisht, rusisht, shqip, serbisht, finlandisht dhe në shumë gjuhë të tjera. Është nderuar me çmime në Greqi dhe jashtë saj. Për përmbledhjen poetike *“Pulsi i heshtjes sime”* (Οι σφυγμοί της σιγής μου) fitoi Çmimin e parë të Akademisë së Athinës më 1935, për poemën *“Athina”* «Αθήνα». Më 1945 i është dhënë Çmimi i parë i Rezistencës Antifashiste. Më 1949 mori Çmimin Ndërkombëtar të Sirakuzës, kurse më 1965 fitoi Çmimin e Shoqërisë Letrare të Grave. Vdiq në Athinë më 1984.<sup>8</sup>

Rita Boumi-Papa vendoset kronologjikisht ndër shkrimtarët grekë të Brezit të Pasluftës. Siç thotë Politis, *“një element kyç i letërsisë së pasluftës është politizimi i madh, kryesisht me shkrimtarët e së majtës”*<sup>9</sup>. Ai e rendit çiftin Papa ndër poetët politikë të angazhuar në ideologjinë e majtë, ku fillojnë veprat e tyre me një frymë lirike dhe nën ndikimin e

kariotakizmit, për të kaluar më vonë në shkrimin realist ku elementi dhe mesazhi politik është gjithmonë i pranishëm. Ajo i qëndroi besnike Partisë Komuniste të Greqisë dhe idealeve të saj deri në fund të jetës së saj. Vepra e saj në thelb karakterizohet nga adhurimi i natyrës dhe paraqet shumë elemente të lirizmit, por edhe të problematikës politike e shoqërore. Shkruan në vargje tradicionale dhe vargje të lira me një teknikë dhe aftësi të lartë shprehëse. Në poezinë e saj gjen elemente të mirëfillta të humanizmit që burojnë nga shpirti i saj i ndjeshëm dhe butësia e saj femërore. Paraqet një larmi jashtëzakonisht të gjerë tematikash, mjetesh dhe teknikash shprehëse dhe përcjell përvoja, dëshira, shqetësime e reflektime filozofike, të cilat i referohen si njeriut, ashtu edhe shoqërisë në tërësi.

Angelos Doxas për vëllimin e saj të parë poetik *“Këngët kushtuar Dashurisë”* (Τα τραγούδια στην αγάπη) arrin në përfundimin se këto janë vargje që të kujtojnë shumë poezinë e Safos. Edhe kritiku tjetër Fanis Mikalopoulos e quan *“Një Safo të re të poezisë”*.<sup>10</sup> Veprat e saj të para i këndojnë dashurisë intime dhe përfshihen tek teknika dhe stili tradicional. Ndryshimi vihet re me poemën *Athinë 1944: “Të dyqindët”* (Αθήνα · Δεκέμβρης 1944) botuar në vitin 1945, ku kthehet në një poete të hapësirës sociale. Vargu tani bëhet më i lirë, me shumë ndikime surrealiste dhe me bashkimin e figurave të ndryshme në dukje, por që të

8. Αρχείο Ελλήνων Λογοτεχνών, Ε.ΚΕ.ΒΙ.

<http://www.ekebi.gr/frontoffice/portal.asp?cpage=NODE&cnode=461&t=287>.

9. Λίνος Πολίτης, Ιστορία της Νεοελληνικής Λογοτεχνίας, ΜΙΕΤ, Αθήνα 2009, f.. 334

10. Ρίτα Μπούμη-Παπά, Άπαντα 1: Αθήνα, Καρανάσης 1981, f. 246.

befasojnë me origjinalitetin e tyre<sup>11</sup>. Një fragment nga kjo poemë është vepra e parë e saj e përkthyer në gjuhën shqipe, botuar në gazetën “Bashkimi”, në qershor 1946 me përkthyes Aleks Çaçin. Poema është e frymëzuar nga ekzekutimi i 200 komunistëve në poligonin e qitjes në Kesariani, nga forcat pushtuese naziste, si hakmarrje për vrasjen e një gjenerali gjerman në një betejë me partizanët në Peloponez. Një dëshmi tronditëse e poetes e cila përjetoi vetë sakrificën e të rinjve nga shtëpia e saj që ndodhej vetëm pak metra larg poligonit të qitjes. Të njëjtën poezi e gjejmë të ribotuar po në gazetën “Bashkimi”, më 1 Maj 1949 dhe te revista *Literatura jonë* më 1949. Poema e plotë botohet te antologjia *Poezia e re greke* që qarkulloi më 1950 si dhe në vëllimin poetik “Një mijë vajza të vrara dhe poezi të tjera” të përkthyer po nga Aleks Çaçi më 1985.

Antologjia *Poezi e re greke*, është një vëllim poetik me rreth 45 faqe, ku përmbledhen poezi të 20 poetëve bashkëkohorë grekë, të përkthyer nga Aleks Çaçi. Në të gjejmë 2 poezi të Rita-Bumi Papa: “Të dyqindët” (Οι διακόσιοι), për të cilën folëm më lart, dhe “Athina” (Αθήνα). Përkthyesi tek “Një mijë vajza të vrara dhe poezi të tjera” e ka rishikuar dhe e ka

ripërkthyer duke bërë disa ndryshime. Konkretisht strofa 1 në greqisht është e përbërë nga 9 vargje të lira. Në përkthimin e vitit 1950 kemi po 9 vargje dhe në atë të 1985-ës 8 vargje. Përkthyesi në të dyja rastet nuk ka përkthyer vargun e 7-të *σταχτινοβόλα χαμομήλια και τα χόρτα* (*kamomila ngjyrë hiri dhe barishte*). Në përkthimin e parë ka shtuar vargun e 5-të *mbi trëndafilin gjak të kuq* që nuk ekziston në origjinalin, as në përkthimin e vitit 1985. Akoma vëmë re se në përkthimin e fundit përkthyesi ka korrigjuar disa fjalë duke i sjellë më afër gjuhës standarte shqipe (zije-zie, djellin – diellin, kamjonat – kamionat) ndërsa fjalën *Χάρος* – *Vdekja* e ka përkthyer me fjalën *xhelat*. Ndryshime gjejmë dhe në strofat e tjera. Përkthimi i vitit 1985 është më afër origjinalit.

1950

Agimi i parë i Majit të sivjetëm  
përhapri perde zije në çdo anë  
që nxinë djellin tonë  
dhe këngën e bilbilit  
mbi trëndafilin gjak të kuq

1985

Agimi i parë i Majit të sivjetëm  
vari perde të mëdha zie  
që nxinë diellin  
dhe zogjtë në degë ndërpre në këngën  
.....

11. Ξένη Σ. Σκαρτσή, Ρίτα Μπούμη-Παπά. Ο μεγαλύτερος ποταμός της γης είναι εκείνος του αίματος, Μανδραγόρας, Τετραμηνιαίο περιοδικό για την τέχνη και τη ζωή, τεύχος 50, Μάιος 2014, f. 13-14

*kur erdhën dëngëzaj kamjonat e xhelatit      tek erdhën kamionat e xhelatit*  
*me rrota të rënda që vithiseshin      me rrota të rënda që vithiseshin*  
*mbushur me djem të dashur të panjohur      mbushur deng me djem të dashur të panjohur*  
*që ngriheshin më këmbë dhe këndonin<sup>12</sup>      që ngriheshin më këmbë dhe këndonin<sup>13</sup>*

*Η πρώτη αυγή του φετινού Μαγίου  
 κρέμασε μεγάλες νεκρικές κουρτίνες  
 που μαύρισαν τον ήλιο  
 και σώπασαν το φλώρι στο ροδιά  
 καθώς ήρθαν του χάρου τα καμιόνια  
 με βουλιαγμένες τις παχιές τους ρόδες  
 σταχτινοβόλα χαμομήλια και τα χόρτα  
 γεμάτα αγαπημένα κι άγνωστα παιδιά  
 που ζητοκραύγαζαν ορθά και τραγουδούσαν<sup>14</sup>*

Në vitin 1985, një vit pas vdekjes së poetes, u botua e vetmja vepër e plotë e saj “Një mijë vajza të vrara dhe poezi të tjera”, përkthyer siç theksuam më lart, nga Aleks Çaçi, me parathënie nga Llazari Siliqi dhe redaktuar nga Pano Çuka. Kjo vepër («Χίλια σκοτωμένα κορίτσια») ka qarkulluar në Greqi në vitin 1963. “Faqet më tragjike, jo vetëm të historisë greke, por të çdo historie kombëtare, janë, pa dyshim, ato që lagu gjaku civil në konfliktet vëllaorase. Por asnjëra nuk mund t’i afrohet nivelit të tragjedisë së një faqeje të historisë greke, brenda së cilës janë grumbulluar qindra emra të rejash, që u dënuan me vdekje gjatë luftës civile (1947-1949) dhe u ekzekutuan, shumica prej tyre në moshën më të njomë dhe pa e njohur akoma dashurinë”, do të shkruajë Rita Bumi-Papa për arsyet që e shtynë të shkruante këto poezi dhe vazhdon “Të gjitha këto vajza të vrara nuk më linin netë të tëra që të fle. I ndieja të ngjitura në jastëkun tim, mbi mua. Kisha lexuar një sërë vendime dënuese, isha kujdesur të informohem për gjëndjen e tyre familjare. Madhështia e tyre morale, i vetmi rast i vetëflijimit të tyre në kronikat historike, jo vetëm më ka tronditur por edhe më ka lidhur fort me to. Ndihesha si nënë e tyre... Dhe më 1947 më erdhi ideja që këtë faqe tragjike dhe heroike të popullit tim ta jepja me figura poetike me qëllim që të mos harroheshin këto

12. Poezi e re greke (1950), përkthyer nga Aleks Çaçi, Ndërmarrja Shtetërore e Boti- meve dhe Shpërndarjes, Tiranë

13. R.B Rita (1985). *Një mijë vajza të vrara dhe poezi të tjera*, përkth. Aleks Çaçi. Tiranë: Naim Frashëri f. 120

14. Ρίτα Μπούμη – Παπά, Αθήνα · Δεκέμβρης 1944. Αθήνα, Τα Νέα Βιβλία, 1945, f. 12

*martire*<sup>15</sup> Originali përbëhet nga 108 faqe. Dy poezitë e para “*Po dola shëtitje me mikeshat e mia të vrara*” dhe “*Vajzat e therorisë*” kanë kuptim përgjithësues. Më pas, poetja, rendit 60 vjersha të titulluara me emra vajzash të vrara që u sakrifikuan në luftën për liri. Irini, edukatorja njëzet e tre vjeç nga Edessa (gruaja e parë që u ekzekutua me vendim të Gjykatës së Jashtëzakonshme Ushtarake), Erasmia punëtorja njëzet vjeçare nga Pireu, Ismeni, Maria, Erifili, Dhanai, Panajo, Dhiamantula gjashtëmbëdhjetë vjeç, baresha Filica, Artemisi nëntëmbëdhjetë vjeç dhe shumë vajza të tjera të vrara padrejtësisht, kalojnë si një kortezh i heshtur e i pafund nëpër faqet e librit.

Përmbledhja në gjuhën shqipe përbëhet nga 168 faqe pasi në të janë përfshirë dhe poezi të tjera të autores. Konkretisht gjenden 2 vjershat e para me kuptim përgjithësues dhe 44 vjersha që u dedikohen vajzave të vrara, si dhe 21 krijime të tjera poetike të autores nga e gjithë vepra e saj voluminoze. Vjersha që mbartnin ndikime kapitaliste, kuptim fetar, intelektualizëm borgjez etj. nuk mund të përktheheshin. Kështu shikojmë se 16 vjersha që janë në origjinalin dhe që nuk përputheshin me sistemin nuk u përkthyen. Psh. nuk u përkthye vjersha *Mirsini* sepse fliste për një vajzë besimtare:

«*Μυρσίνη χρυσοπράσινη, της εκκλησιάς στολίδι*  
*Δίχως εσέ δε γίνεται κανένα πανηγύρι*»<sup>16</sup>

*“Myrsini ti e artë, e kishës xhevahir*  
*pa ty, nuk bëhet dot as edhe një panair”.*

Në botimin shqip gjejmë dhe në vjershë kushtuar Shqipërisë, “*Shqipëria – Vendi i shqiponjave*” ( Η Αλβανία – Η χώρα των αετών), ku shpreh ndjenjat e miqësisë për Shqipërinë dhe shqiptarët.

Aleks Çaçi, përkthyesi i veprës së Bumit, poet vetë, vjen me një përvojë përkthyesë të gjerë nga letërsia greke në atë shqipe. Ka qenë ndër njohësit më të mirë të gjuhës, kulturës dhe letërsisë greke, pasi Shkollën e Lartë e kreu në Greqi. Në përkthimet e tij vërehet një punë e kujdesshme e një përkthyesi me përvojë, që mundohet të sjellë në gjuhën shqipe atë që provon lexuesi grek kur lexon Rita –Bumi Papanë. Nëse tentojmë një paraqitje të mundshme krahasuese të dy

15. Ρίτα Μπούμη - Παπά (1963), Χίλια σκοτωμένα κορίτσια. Αθήνα, Το σπίτι του ποιητή, f. 9

16. Ρίτα Μπούμη - Παπά (1963), Χίλια σκοτωμένα κορίτσια. Αθήνα, Το σπίτι του ποιητή, f. 35

teksteve, vihet re se Çaçi po përpiket t'i qëndrojë besnik origjinalit në tri nivele: semantik, stilistik dhe morfo-sintaksor. Siç thekson Llazar Siliqi: *"Aleks Çaçi ia ka dalë të na transmetojë, përmes përkthimit të vet nga origjinali, ndjeshmërinë poetike, lirizmin e veçantë, frymëzimin e sinqertë, dhe dashurinë e madhe të poeteshës për popullin, për njerëzimin, për lirinë dhe drejtësinë"*.<sup>17</sup> Përkthimi i tij është i orientuar nga origjinali dhe fokusohet te ajo që ishte e lejuar: vargje, shprehje, fjalë që nuk devijonin nga metoda zyrtare. Përkthimi shqip mban të njëjtin kopertinë jo me botimin e parë por me ribotimin e vitit 1974.

Në vitin 1986 u botua *Antologjia e poezisë greke*, përgatitur nga Pirro Misha. Parathënien e ka bërë Ismail Kadare dhe recensentë ishin Pano Çuka dhe Fatos Arapi. Në të përfshiheshin disa pjesë nga krijimtaria popullore dhe jepej një panoramë e përgjithshme e poezisë greke me vepra të zgjedhura nga 46 autorë grekë, mes tyre dhe 6 gra. Në kushtet e censurës së fortë ky botim mund të interpretohet si një përpjekje për të njohur nga afër fqinjin e panjohur, një parim të cilin e kishte adoptuar udhëheqja komuniste e Shqipërisë së atëhershme. Botimi i antologjisë përbënte një ngjarje të shënuar në njohjen e poezisë greke në Shqipëri. Ishte edhe një komunikim midis krijuesve, ngaqë në përkthimin e autorëve të përzgjedhur morën pjesë shumë përkthyes dhe poetë shqiptarë.<sup>18</sup> Rita Bumi – Papa përfaqësohet me 6 poezi të cilat i pamë edhe te botimet e mëparshme: *"Pema"* (Το δέντρο) *"Shqipëria – Vendi i shqiponjave"* (Αλβανία – Η χώρα των αετών), *"Mos më prek"* (Μη με αγγίζεις), *"Korbi"* (Ο κόρακας), të përkthyer nga Aleks Çaçi dhe *"Po të dal të shëtis me shoqet e mia të vdekura"* (Αν βγω περίπατο με τις νεκρές μου φίλες), *"Irimi"* (Ειρήνη), të përkthyer nga Petro Çerkezi.

Poetja së bashku me bashkëshortin e saj, gjithashtu poet dhe kritik, Niko Papa erdhën në Shqipëri në gusht të vitit 1980, me ftesë të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë

*"Gjatë qëndrimit të tyre në Shqipëri ata bënë vizita në institucione social-kulturore, në qendra pune e kooperativa bujqësore, ku u takuan me shkrimtarë, punonjës të kulturës, punëtorë e kooperativistë"*.<sup>19</sup> . Atë periudhë vizituan Shqipërinë dhe figura të tjera të letërsisë dhe artit si shkrimtari Llambros Mallamas, shkrimtari dhe gazetari Janis Sarras si dhe piktori Dimitris Joldasis. Interesi i Shqipërisë nga kjo vizitë ishte

17. R.B Rita (1985). *Një mijë vajza të vrara dhe poezi të tjera*, përkth. Aleks Çaçi. Tiranë: Naim Frashëri f. 13

18. Aristotel Spiro (2019) Krahime të përkthimeve të Kostandin Kavafit në gjuhën shqipe, <https://exlibris.al/krahime-te-perkthimeve-te-kostandin-kavafit-ne-gjuhen-shqipe/>

19. Zëri i popullit, nr. 213, e shtunë 6 shtator 1980, f. 4, Drita, 26 tetor 1980, f.16

kryesisht propagandistik dhe përfitimet që synonte ishin forcimi i marrëdhënieve me Greqinë dhe zbatimi i propagandës komuniste jashtë vendit, nëpërmjet artikujve që do të botoheshin e që do të evidentonin arritjet e komunizmit. Ata “mbeten të mahnitur” nga arritjet e regjimit dhe në veprat e tyre lavdërojnë arritjet komuniste duke shprehur qartë pikëpamjet e tyre të majta. Në Pogradec më 28 gusht 1980 Rita u frymëzua dhe shkruajti poezinë e saj kushtuar Shqipërisë “*Shqipëria – Vendi i shqiponjave*” ( Η Αλβανία – Η χώρα των αετών). Jehona e vizitës së tyre në qarqet e shkrimtarëve dhe në shtypin shqiptar është e madhe. Shtypi i kohës i referohet vizitës së Rita Bumit dhe bashkëshortit të saj Nikos Papas. Në Pogradec, çifti Papa i shoqëruar nga Lllazar Siliqi u takua edhe me Lasgush Poradecin. Petraq Kolevica në librin publicistik-monografik, titulluar “*Lasgushi më ka thënë...*”, botuar më 1992 rrëfen për këtë takim: “Në ora G pa një çerek shkova ta marr. Lasgushi ishte gati, i veshur me kostumin e zi, «të përjetshmin», bastunin në krahun e majtë, kalorthi. Nisemi për në takim pa u nxituar. . . Me t’u qasur «Albturistit» vumë re se miqtë kishin dalë të na presin te dera kishin dalë të na presin te dera . Nja tri-katër metra larg tyre Lasgushi u ndal me një herë në vend dhe recitoi greqisht:

*Në tokën e djegur të Psarasë Zbriti Lavdia,*

*që të numërojë të rënët.*

*Në krye kishte thurrur një kurorë*

*Me ato pak fije bari,*

*që mbetën nga zjarri.*

*Ishte vjersha e poetit grek Solomos... Miqtë, Rita Bumi Papa dhe i shoqi, të befasuar ngritën duart përtpjetë me gëzim dhe zbritën nga shkallët përqafojnë Lasgushin. Jo vetëm në ato grima, por dhe në orë të vona dhe të nesërmen, Lasgushi i mrekulloi miqtë ”<sup>20</sup>*

Edhe shkrimtari i madh Dritëro Agolli takoi çiftin Papa dhe shkruan për të: “Mua fati më ka sjellë jo vetëm të lexoj edhe të përkthej shumë poetë e prozatorë grekë, por edhe të njoh disa prej tyre, madje t’i kem edhe miq, si Andonis Samaraqis, që i kam shkruar edhe parathënien e romanit të tij “*Gabimi*”, përkthyer në shqip. Kam njohur poeten e famshme, miken e vendit tonë Rita Bumi Papa bashkë me të shoqin e saj, Nikon”.<sup>21</sup>

20. Petraq Kolevica (1992), *Lasgushi më ka thënë...*, Shtypshkronja Tirana, Tiranë, f.233-234

21. Dritëro Agolli, *Historia ime e fëmijërisë me mikun grek Pavlos nga Lufta e Dytë Botërore*, <https://www.pelasgoskoritsas.gr/2021/02/historia-ime-e-femijerise-me-mikun-grek.html>

Pas kthimit të tyre në Greqi, Rita flet me admirim e me hollësi për Shqipërinë dhe shqiptarët. Në revistën *“Erevna”* në tre numra të vitit 1980 boton artikullin me temë *“Ngjitja epike e një populli të vogël”*. E entusiazmuar nga përkthimet e letërsisë greke në Shqipëri thekson: *“Në udhëtimin tim në Shqipëri në vitin 1980, konstatova në bibliotekën e një fshati poemat epike të Homerit dhe dy komedi të Aristofanit të përkthyer në gjuhën shqipe. Konsumimi i faqeve dëshmonte se sa shumë ishin lexuar këto libra. Në një fshat tjetër, një fermer më tregoi Plutarkun, të cilin e pëlqente, siç më tha, më shumë se të gjithë autorët e lashtë grekë!”*<sup>22</sup>

Rita Bumi Papa i ka kushtuar një vend të rëndësishëm letërsisë shqipe në *“Antologjinë e poezisë botërore”*. Në faqen 1107 të vëllimit III, ajo shpreh simpatinë e saj të veçantë për poezinë shqiptare. *“Ata ishin grekët e parë që në vitet 1950 u kujdesën të përfshihej në një antologji poetike botërore dhe poezia e poetëve shqiptarë. Një kujdes që në çdo rast, në çdo kohë, është i lavdërueshëm”*<sup>23</sup>.

Gjatë periudhës së tretë të përkthimeve nga gjuha greke në atë shqipe, 1991 e në vazhdim, nuk kemi asnjë përkthim të saj

### Përfundimet

Rita Bumi Papa është poetja e parë e letërsisë bashkëkohore greke që përkthehet në gjuhën shqipe. Vepra e saj e gjerë përfshin poezi, tregime të shkurtra, romane, antologji poetike, letërsi udhëtimi dhe përkthime të veprave të poetëve dhe prozatorëve jo vetëm nga vendet e Ballkanit, por pothuajse nga e gjithë Evropa. Renditet ndër poetët lirikë të angazhuar në ideologjinë e majtë. Vepra e saj e parë e përkthyer në shqip është një fragment nga poema *Athinë 1944: “Të dyqindët”* (Αθήνα · Δεκέμβρης 1944) botuar në gazetën *“Bashkimi”*, në qershor 1946 me përkthyes Aleks Çaçin. Poema është e frymëzuar nga ekzekutimi i 200 komunistëve në poligonin e qitjes në Kesariani të Athinës, nga forcat pushtuese naziste. Të njëjtën poezi e gjejmë të ribotuar po në gazetën *“Bashkimi”*, më 1 Maj 1949 dhe te revista *Literatura jonë* më 1949. Poema e plotë botohet te antologjia *Poezia e re greke* që qarkulloi më 1950 si dhe në vëllimin poetik *“Një mijë vajza të vrara dhe poezi të tjera”* të përkthyer po nga Aleks Çaçi më 1985. Ky vëllim

22. Ρίτα Μπούμη – Παπά, Η παγκοσμιότητα της Ελληνικής Ποίησης, περιοδικό Περίπλους, Τετράδιο για τα γράμματα και τις τέχνες, τεύχος 3 Φθινόπωρο 1984, f.168

23. Πάνος Τσοούκας, 1995, *Ζηλευτό πνευματικό ζευγάρι*, Ριζοσπάστης, Κυριακή 1 Γενάρη, f. 19

është e vetmja vepër e plotë e saj e përkthyer në shqip. Flet për qindra emra të rejash, që u dënuan me vdekje gjatë luftës civile në Greqi (1947-1949) Në vitin 1986 u botua *Antologjia e poezisë greke*, përgatitur nga Pirro Misha. Rita Bumi – Papa përfaqësohet me 6 poezi të cilat i pamë edhe te botimet e mëparshme të përkthyer nga Aleks Çaçi dhe nga Petro Çerkezi. Poetja së bashku me bashkëshortin e saj, gjithashtu poet dhe kritik, Niko Papa erdhën në Shqipëri në gusht të vitit 1980, me ftesë të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë. Jehona e vizitës së tyre në qarqet e shkrimtarëve dhe në shtypin shqiptar ishte e madhe.

#### BIBLIOGRAFIA

- Αρχείο Ελλήνων Λογοτεχνών, Ε.ΚΕ.ΒΙ.
- <http://www.ekebi.gr/frontoffice/portal.asp?cpage=NODE&cnode=461&t=287>).
- Γκόρκυ, Μ., Ο σοσιαλιστικός ρεαλισμός, μτφ. Ανδρέας Σαραντόπουλος, Σύγχρονη πεζογραφία, Αθήνα: 1979.
- Γραμμενίδης Σ. Μεταφράζοντας τον κόσμο του Άλλου: Θεωρητικοί προβληματισμοί – λειτουργικές προσεγγίσεις, Αθήνα: Δίαυλος, 2009.
- Δημητρούλια, Τ. και Κεντρωτής, Γ. Λογοτεχνική μετάφραση. Θεωρία και πράξη. Αθήνα: Κάλλιπος 2015, f.157 Κασίνης, Κ.Γ.: Διασταυρώσεις. Μελέτες για τον Ιθ' και Κ' αι., τόμ. Α', β' έκδοση, Εκδόσεις Χατζηνικολή, Αθήνα 2003, f.11
- Λίνος Πολίτης, Ιστορία της Νεοελληνικής Λογοτεχνίας, ΜΙΕΤ, Αθήνα 2009, f. 334
- Ξένη Σ. Σκαρτσή, Ρίτα Μπούμη-Παπά. Ο μεγαλύτερος ποταμός της γης είναι εκείνος του αίματος, Μανδραγόρας, Τετραμηνιαίο περιοδικό για την τέχνη και τη ζωή, τεύχος 50, Μάιος 2014, f. 13-14
- Πάνος Τσούκας, 1995, **Ζηλεύτο πνευματικό ζευγάρι**, Ριζοσπάστης, Κυριακή 1 Γενάρη, f. 19
- Πυρρος: δίμηνο εικονογραφημένο εκπολιτιστικό περιοδικό, Δρέσδη, Γερμανία, τχ.3, 4(1965)
- Ρίτα Μπούμη – Παπά, Αθήνα · Δεκέμβρης 1944. Αθήνα, Τα Νέα Βιβλία, 1945.
- Ρίτα Μπούμη - Παπά (1963), Χίλια σκοτωμένα κορίτσια. Αθήνα, Το σπίτι του ποιητή.
- Ρίτα Μπούμη-Παπά, Άπαντα 1: Αθήνα, Καρανάσης 1981, f. 246.
- Ρίτα Μπούμη-Παπά, Η Χρυσώ, Αθήνα, Καρανάσης 1984 f. 179.
- Ρίτα Μπούμη – Παπά, Η παγκοσμιότητα της Ελληνικής Ποίησης, περιοδικό Περίπλους, Τετράδιο για τα γράμματα και τις τέχνες, τεύχος 3 Φθινόπωρο 1984, f. 168
- *Antologji e poezisë greke*, (1986), Piro Misha, Shtëpia botuese Naim Frashëri, Tiranë
- Aristotel Spiro (2019) *Krahasime të përkthimeve të Kostandin Kavafit në gjuhën shqipe*, <https://exlibris.al/krahasime-te-perkthimeve-te-kostandin-kavafit-ne-gjuhen-shqipe/>
- Bumi – Papa Rita (1965), *Krini*. Poezi greke, Perkt. A. Çaçi – Në gaz: Drita, 4 prill
- Bumi-Papa, Rita (1985). *Një mijë vajza të vrara dhe poezi të tjera*, përkth. Aleks Çaçi. Tiranë: Naim Frashëri
- Dritero Agolli, *Historia ime e femijërisë me mikun grek Pavlos nga Lufta e Dytë Botërore*, <https://www.pelagoskoritsas.gr/2021/02/historia-ime-e-femijerise-me->

mikun-grek.html

- Ladmiral, J.R. (2007). Θεωρήματα για τη μετάφραση (μτφ. Κ. Κολλέτ, Μ.Χ. Αναστασιάδη). Αθήνα: Μεταίχμιο.
- Lazër Stani, *Censura dhe shkrimtarët shqiptarë në diktaturë*, 12 Mars 2021, <https://www.panalbanian.com/shqiperia/censura-dhe-shkrimtare-shqiptare-ne-diktature/>
- Munday, J. (2004). Μεταφραστικές σπουδές: θεωρίες και εφαρμογές (μτφ. Α. Φιλίππας). Αθήνα: Μεταίχμιο.
- PAPA. R. B. *Të dyqintët* (poezi e re greke perkth. nga Alelis Çaçi), Bashkimi, 1946, 16 qershor.
- Papa. R. B. *Të dyqintët* (poezi e re greke), Përkth. Aleks Çaçi, Bashkimi 1949, 1 Maj
- Papa. R. B. *Të dyqintët* (poezi e re greke) Literatura jonë, 1949, nr 2-3, f. 59 – 63
- Petraq Kolevica (1992), *Lasgushi më ka thënë...*, Shtypshkronja Tirana, Tiranë, f. 233-234
- *Poezi e re greke* (1950), përkthyer nga Aleks Çaçi, Ndërmarja Shtetërore e Botimeve dhe Shpërndarjes, Tiranë